



Ajetin **94** dhe **95** të sures **Bekare**.

"Thuaj: "Nëse bota tjetër (Xhenneti) te All-llahu është vetëm për ju, edhe për njerëzit e tjerë, nëse jeni të sinqert, kërkone vdekjen (e shkoni më shpejtë)".

"E për shkak të veprave të tyre (mëkateve), ata kurr nuk e dëshirojnë atë. All-llahu di për zullumqarët".

Çifutët gjatë gjithë historisë e kanë konsideruar veten si race superior dhe janë të mendimit se parajsa është krijuar vetëm për ata. Zjarri i xhehenemit nuk është për ata sepse ata janë bijtë dhe miqtë e Zotit. Këto mendime të gabuara u bënë shkak që nga njëra anë të kryejnë lirisht çdo mëkat, krim dhe padrejtësi dhe nga ana tjetër të kaplohen nga mendjemadhësia dhe ndjenja e supremcisë ndaj të tjerëve. Ky ajet teston ndërgjegjen e tyre dhe thotë: Nëse është vërtetë si pretendoni ju dhe nëse parajsa është vetëm e juaja, atëherë përse nuk kërkoni të vdisni dhe hyni sa më parë në parajsë? Përse keni frikë dhe largoheni nga vdekja? Frika nga vdekja është si frika e shoferit nga udhëtimi. Shoferi frikësohet ose për shkak se nuk e njeh rrugën, ose nuk ka benzinë, ose ka kryer kundravajtje, ose transporton mallra kontrabandë, ose nga fakti se në destinacion nuk ka vend për tu strehuar. Ndërkohë besimtari i vërtetë e njeh rrugën, me veprat e mira ka siguruar lëndën e nevojshme për udhëtim, me pendimet e tij ka shlyer kundravajtjet, me vete nuk ka mallra kontrabandë domethënë mëkate dhe padrejtësi dhe në ditën e kiametit ka vend për tu strehuar domethënë parajsën. Shumica e njerëzve që frikësohen nga vdekja ose e konsiderojnë vdekjen si fund i gjithçkaje dhe natyrisht çdo gjallesë frikësohet nga zhdukja, ose kanë kryer vepra të këqija dhe padrejtësi sepse vdekja është fillim i llogarive për veprat e njerëzve në këtë botë. Profetët dhe të dashurit e Zotit nuk e konsiderojnë vdekjen si zhdukje, por si fillim i një jete të re dhe meqenëse në jetën e tyre të begatë kanë pasur vetëm mendime dhe vepra të mira jo vetëm që nuk frikësohen nga vdekja, por e dëshirojnë atë. Prijësi i besimtarëve Imam Aliu a.s. në lidhje me veten e tij thekson: Beto hem në Zot se dëshira e birit të Abu Talebit për vdekjen është më e madhe se dëshira e foshnjës për gjirin e nënës.

Tani le të ndjekim ajetin **96** të sures **Bekare**.

"Është e sigurt se njerëzit më lakmues për të jetuar, ti ke për të gjetur ata (jehuditë), bile edhe më lakmues se idhujtarët. Ndonjëri prej tyre dëshiron të jetojë njëmijë vjet, por edhe sikur të jetojë, ajo (jeta e gjatë) nuk do ta shpëtoj atë prej dënimit. All-llahu sheh çka veprojnë ata."

Ky ajet i drejtohet Pejgamberit dhe thotë: Jahuditë që pretendojnë se parajsa është monopol i tyre jo vetëm që nuk e dëshirojnë vdekjen që të hyjnë sa më shpejt në parajsë, por janë më lakmues për të jetuar sesa idhujtarët të cilët nuk besojnë tek dita e kiametit dhe e konsiderojnë vdekjen si fundin e gjithçkaje. Ata janë aq shumë të dhënë pas jetës në këtë botë sa që duan të jetojnë 1 mijë vjet edhe nëse kanë mënyrën më të shëmtuar të jetesës në mënyrë që t'i largohen dënimit hyjnorë dhe të vazhdojnë përpjekjet për mbledhjen e pasurive dhe të mirave të kësaj bote, por Zoti thekson: Edhe nëse dëshira e tyre për të jetuar 1 mijë vjet do të realizohej, ata nuk do ti shpëtojnë

dënimet hyjnor sepse të gjitha veprat e tyre vëzhgohen nga Zoti dhe kjo dëshirë fëmijërore nuk çon askund.

Tashmë le të ndjekim ajetet **97** dhe **98** të sures **Bekare**.

"Thuaj: Kush është armik i Xhibrililit (është armik i All-llahut), e ai me urdhrin e All-llahut e zbriti Kur'anin në zemrën tënde, që është vërtetues i asaj që ishte më parë dhe udhërrëfyes e përgëzues për besimtarët"

"Kush është armik i All-llahut, i engjëjve të Tij, i të dërguarve të Tij, i Xhibrililit dhe i Mikaililit (ai është mosbesimtar), All-llahu është pa dyshim armik i mosbesimtarëve."

Kut profeti i Islamit shkoi në Medine disa jahudi sëbashku me një dijetar të tyre shkuan tek profeti dhe i drejtuan disa pyetje. Ata e pyetën se kush është engjëlli që i zbret atij shpallje. Kur profeti tha se ai engjëll është Xhebraili, çifutët thanë: Nëse do të ishte Mikaili, ne do të të besonim sepse Xhebraili është armiku ynë dhe na jep urdhra të vështira sic është xihadi. Kur njeriu nuk dëshiron të pranojë të vërtetën gjen lloj-lloj pretekstesh, madje është i gatshëm të akuzojë edhe engjëjt hyjnorë për t'iu shmangur pranimit të së vërtetës. Kjo është njësoj si ai nxënësi i pabindur i cili mësuesin e matematikës e quan të keq dhe mësuesin e edukimit fizik e quan të mirë. Engjëjt hyjnorë qoftë Xhebraili apo Mikaili nuk sjellin ndonjë gjë nga vetja që të mund të urrehen apo të duhen. Ata nuk bëjnë asgjë pa urdhrin e Zotit dhe janë vetëm ndërmjetësues mes Zotit dhe profetëve, prandaj fjalët e jahudive ishin vetëm pretekst për të shmangur pranimin e Islamit.

Tani do të ndjekim mësimet që nxjerrim nga këto ajete:

1- Njeriu duhet të jetojë në mënyrë të atillë që në cdo cast të jetë i gatshëm për vdekjen. Njeriu duhet të ketë zbatuar me përpikmëri detyrat e tij dhe cdo mëkat ta ketë korrigjuar me pendim në mënyrë që të mos ketë frikë nga vdekja.

2- Jeta e gjatë nuk është e rëndësishme, por e rëndësishme është jeta nën bindjen e plotë ndaj Zotit. Imam Saxhadi a.s. në një lutje të tij thotë: O Zot nëse jeta ime është mjet për tu bindur dhe për të të shërbyer Ty, atëherë ma zgjat jetën dhe nëse jeta ime shërben për realizimin e qëllimeve të djallit, ndërpreje atë.

3- Feja është një tërësi detyrash dhe të drejtash për zbatimin e të cilave është i nevojshëm besimi. Nuk mund të themi se besojmë Zotin, por këtë engjëll e kemi armik dhe atë profet nuk e besojmë. Besimtari i vërtetë është ai që beson tek të gjithë profetët dhe tek të gjithë engjëjt e Zotit.

Marre nga: <http://albanian.trib.ir>